VENDIM
Nr. 235, datë 19.3.2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në fund të pikës 1/2, shtohet emërtesa "Njësia Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion".

b) Pas pikës 8/11 shtohet pika 8/12, me këtë përmbajtje:

"8/12. Kategoritë e pagave të nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni", në Njësinë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion, janë sipas lidhjes nr.5/12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Zbatimi i këtij vendimi dhe efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i tij, për vitin 2020, të përballohen nga fondet e miratuara për Njësinë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion, dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 5/12

Kategoritë e pagave dhe shtesat mbi pagë të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni", në Njësinë Speciale Antikorrupsion dhe Antievazion

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Titullar i institucionit.	II-a	1
Koordinator.	II-b	1
Specialist.	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3